



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2017

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Për:** Operatorin ekonomik “W.Center” sh.p.k me nr. NIPT-i K63029402A , me administrator Z.Bledar Shemaj, me adresë: Fier, Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2 katësh, përballë “Gjymnazit Perikli Ikonomi”.

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Blerje Kimikate për UKT sh.a”

**Fondi Limit:** 97,678,724 (nëntëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** Të ardhurat e SH.A Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 muaj duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës..

**Data e zhvillimit të tenderit është:** 18.01.2017

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Nr. 51 date 27/12/2016

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik JV “T&M CHEMICAL DISTRIBUTION” sh.p.k. NIPT L41823009V

& “CONTIVENST” LTD,

Vlera: **77,777,159.31** (shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pike tridhjetë e një) **lekë pa TVSH.**

2. Operatori ekonomik “W.Center” sh.p.k

NIPT K63029402A

Vlera: **96,944,359** (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “ATLANTIK-3” sh.p.k

NIPT K22218003V

Vlera: **97,567,122** (nëntëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e dy ) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “2AT” sh.p.k.

NIPT K14019001H

Vlera: **Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J620050020

**5. Operatori ekonomik “2MJ” sh.p.k me NIPT L223190130**

Vlera: **nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**

**6. Operatori ekonomik “MIQESIA” sh.p.k i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**

**Janë skualifikuar për arsye si më poshtë:**

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik JV “T&M CHEMICAL DISTRIBUTION” sh.p.k. & “CONTIVENST” LTD, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr.107 rep. dhe nr.38/1kol. nga shoqëria “T&M CHEMICAL DISTRIBUTION” SH.P.K. me nr. NIPT-i L41823009V me administrator Z.Taulant Jakupi, me ofertë ekonomike me vlerë prej **77,777,159.31** (shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pike tridhjetë e një) **lekë pa TVSH, i cili ka** mangësi në dokumentacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimit/Kualifikimit si më poshtë
  - **Shoqëria “T&M CHIMICAL“ sh.p.k. nuk plotëson kriterin e vendosur ne piken 2.3.1** te DST, pasi per kontratat e lidhura nga autoriteti kontraktor faturat duhet te jene te shoqeruar me kontrate ,vertetimin e realizimit dhe Faturat e TVSH. Ne rastin konkret ka faturat e leshuar nga ujesjellesi Novosele dhe ujesjellesi Lushnje jane te pashoqeruar me kontrata dhe vertetim realizimi.
  - Nuk plotëson kriterin e vendosur ne piken 2.3.1 pasi operatori ekonomik ka paraqitur faturat e leshuar nga ujesjellesi Novosele dhe ujesjellesi Lushnje te pashoqeruar me kontrata dhe vertetim realizimi.
  - Kompania Continvest ka paraqitur vetem nje kontrate furnizimi me nje kompani te huaj (konstatohet se eshte institucion shteteror) dhe per kete kontrate nuk ka paraqitur fature shitje malli ose vertetim per realizimin e kontrates, por vetem nje leter reference nga nje tjetër kompani. Rrjedhimisht keto dokumenta nuk merren parasysh.
  - Certifikatat ISO 9001, 14001 dhe 18001 jane te leshuara nga kompani certikuese te cilat jane te akredituara por akreditimet nuk jane paraqitur. Sic eshte kerkuar ne piken 2.3.3
  - Per vertetimin e xhiros T&M chemicals distribution ka paraqitur xhiron per vitin 2014 dhe 2015 (sepse eshte krijuar ne vitin 2014) nderkohe qe ne kriteret eshte kerkuar edhe per 2013. Nese per vitin 2013 xhiroja e shoqerise do te quhet 0 leke, vlera mesatare per 3 vjetet e fundit e shoqerise T&M chemicals distribution nuk eshte sa 20% e fondit limit (bazuar ne kontraten e basjkepunimit) sic eshte kerkuar ne kriteret per kualifikim.
  - Ne kriteret e vecanta per kualifikim ne piken 2.2.2 jane kerkuar bilancet e kompanive per vitet 2013, 2014 dhe 2015 sebashku me të shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar. Kompania Continvest ka paraqitur tre bilancet se bashku me akt ekspertizen e kryer



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J62005002O

nga Eksperti kontabël i autorizuar perkates. Bazuar ne perkthimet e bera, bilancet nuk jane te plota. Ne cdo bilanc thuhet tekstualisht se “Aneksi nga faqja 5 deri ne faqen 33 eshte pjese perberese e pasqyrave financiare” nderkohe qe te gjithë bilancet e paraqitur sebashku me pjesen e perkthimeve dhe noterizimeve jane me pak se 23 faqe. Rrjedhimisht bilancet nuk jane te plote.

- Ne kriteret e vecanta per kualifikim ne piken 2.2.2 jane kerkuar bilancet e kompanive per vitet 2013, 2014 dhe 2015 sebashku me të shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar. Akt ekspertiza e paraqitur nga kompania T&M Chemicals distribution shpk ka probleme sepse 4 faqet e para jane dokumenta origjinal (jane me ngjyra) dhe pjesa tjeter jane bardh e zi (pra jane fotokopje te tyre) kur ne fund te kriterëve per kualifikim theksohet se të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Gjithashtu ne faqen e 5 te po ketij dokumenti pasqyra e pozicionit financiar (Balanci)-Aktiv, vihet re se ky dokument eshte per kompanine KU&KO sh.p.k. dhe jo per kompanine T&M Chemicals distribution shpk. Rrjedhimisht ky dokument quhet I pasakte.
  - Certifikatat REACH te paraqitura nga bashkimi I operatoreve ekonomik nuk jane te leshuara te emer te prodhuesit te supozuar (Continvest) por ne emer te prodhuesve te tjere, pra nuk mund te merren si te mireqena. Kjo vertetohet me ane te numrave dhe ose certifikatave REACH qe ata kane paraqitur ku prodhuesi I produkteve nuk eshte Continvest. Nuk ekziston asnje kontrate ndermjet Continvest dhe prodhuesve te mallrave qe jane te deklaruar ne certifikatat REACH.
  - Perkthimi i dokumentave nga gjuha bullgare ne gjuhen Shqipe eshte bere nga nje perkthyes I cili nuk eshte ne listen e perkthyesve te njohur nga Ministria e Drejtesise per vitin 2017. Gjithashtu nje pjese e dokumentave te cilat jane te perkthyer ne gjuhen Shqipe, nga noteria jane te deklaruar se jane perkthyer nga gjuha Bullgare ne gjuhen Shqipe nderkohe qe brenda dokumentit ka dhe perkthime nga gjuha Angleze ne gjuhen Shqipe.
  - Perkthimi i dokumentave nga gjuha bullgare ne gjuhen Shqipe eshte bere nga nje perkthyes I cili nuk eshte ne listen e perkthyesve te njohur nga Ministria e Drejtesise per vitin 2017. Gjithashtu nje pjese e dokumentave te cilat jane te perkthyer ne gjuhen Shqipe, nga noteria jane te deklaruar se jane perkthyer nga gjuha Bullgare ne gjuhen Shqipe nderkohe qe brenda dokumentit ka dhe perkthime nga gjuha Angleze ne gjuhen Shqipe.
  - Theksojme qe operatori ekonomik nuk po permbush me sukses kontraten e lidhur me autoritetin kontraktor UKT sha, nuk po rrespekton grafikun e levrimit.
2. Operatori ekonomik “**ATLANTIK-3**” **sh.p.k** me nr. NIPT-i K22218003V, me administrator Z.Teki Hoxha, me ofertë ekonomike me vlerë prej 97,567,122 (nëntëdhjet e shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e dy ) lekë pa TVSH, **ka** mangësi në



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J62005002O

dokumentacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimit/Kualifikimit si më poshtë:

Operatori ekonomik nuk ka përmbushur këto pika të kriterëve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimit/Kualifikimit:

**2.3.1** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit financiare, me vlerë sa 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Kontratat e ngjashme të jenë të shoqëruar me vertetimin e realizimit nga autoriteti kontraktor ose me subjekte private të paraqiten faturat përkatëse tatimore të shitjes ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

**2.3.4** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, për analizë toksikologjike për produktet që prokurohen (3 muajve të fundit).*

**2.3.5** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Ministria e shëndetësisë, për Importin dhe tregtimin e produkteve objekt prokurimi.*

**2.3.6** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e prodhuesit që verteton konformitetin e produktit në prokurim me normat Europiane (EN;883;2006) dhe (EN 939;2009) dhe (EN 901;2013) Produkte kimike për tregtimin e produkteve për trajnimin e ujit të destinuar për konsum njerezor, konform normave europiane.*

**2.3.7** *Ofertuesi Ekonomik ose furnitori i tij duhet të garantojë sasitë e produkteve të prokuruar në këtë procedurë, nëpërmjet; (a) nëse është prodhues me një deklaratë të tij (b) nëse është tregtues duhet të disponojë një kontratë me prodhuesin(t) për sasinë e prokuruar të barabartë ose më të lartë nga ajo e kërkuar në këtë procedurë.*

**2.3.8** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë **Reach** të prodhuesit i cili verteton se prodhuesi(t) është i regjistruar dhe i certifikuar për tregtimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsum njerezor në komunitetin Europian.*

**2.3.9** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Certifikatë/Leje/Liçensë** e leshuar nga autoriteti kompetent për **“Transport lende të rrezikshme” (ADR)** e shoqëruar detyrimisht me **Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje** (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme deri në fund të perfundimit të kontratës, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikateve.*

3. Operatori ekonomik **“2AT” sh.p.k.** me nr. NIPT-i K14019001H, me administrator Z.Nuçi Shamija, **i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**

4. Operatori ekonomik **“2MJ” sh.p.k** me NIPT L22319013O me administrator Zj. Mamica Jançe, **nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

## 5. Operatori ekonomik “MIQESIA” sh.p.k i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatorin ekonomik “W.Center”sh.p.k me nr. NIPT-i K63029402A , me administrator Z.Bledar Shemaj, me adresë: Fier, Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2 katësh, përballë “Gjimnazit Perikli Ikonomi, me ofertë ekonomike me vlerë prej **96,944,359 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH**, se është **identifikuar si oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23/01/2017.

Ankesa: Ka ardhur ankesa Nr 1501 prot date 30.01.2017 nga operatori ekonomik “T&M CHEMICAL DISTRIBUTION” sh.p.k, të cilit është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1501/1 Prot date 06.02.2017. duke mos e pranuar ankesën e drejtuar prej tij.

Gjatë afatit për ankesa në KPP: Nuk ka pasur ankesë.